



This project is funded by European Union

Thirrje për Pjesëmarrje në projektin ARISE

(Action for Reducing Inequalities in Education / Iniciativa për zvogëlimin e pabarazive në arsim)

Konzorciumi i projektit ARISE fton përzemërsisht të gjitha organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të) e interesuara të aplikojnë për të marrë pjesë në projektin ARISE.

Konzorciumi synon të zhvillojë kapacitetin e organizatave me bazë në komunitet (grassroots) të përzgjedhura për të mbështetur nxënësit me Status Social-Ekonomik të ulët nëpërmjet mentorimit, pjesëmarrjes në zhvillimin e politikave dhe avokimit në fushën e barazisë në arsim si edhe pjesëmarrjes në aktivitete të rrjetëzimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Organizata me bazë në komunitet (grassroots) pritet të bashkëpunojnë ngushtë me organizatën anëtare të Konzorciumit në vendin e tyre, në këtë rast në Kosovë (Qendra për Arsim e Kosovës – KEC) në çdo fazë të projektit ARISE dhe do të jenë një zë i fuqishëm avokues për zbatimin dhe shtrirjen e politikave dhe praktikave të rekomanduara. Konzorciumi do të mbështesë ngritjen e kapacitetit të OSHC-ve të përzgjedhura nëpërmjet një sërë aktiviteteve të të nxënies të mirëplanifikuara.

Gjithashtu, OSHC-ja e përzgjedhur dhe organizata anëtare e Konzorciumit (në këtë rast KEC) do të zhvillojnë së bashku një projekt që mbështet integrimin e fëmijëve me Status Social-Ekonomik (SSE) të ulët në jetën e komunitetit. Projekti pritet të zgjasë nga 24 deri në 30 muaj dhe do të financohet nga Konzorciumi me një grant nga 25,000 deri në 35,000 EUR.

Ç'është projekti ARISE?

ARISE (Action for Reducing Inequalities in Education / Iniciativa për zvogëlimin e pabarazive në arsim) është një Projekt rajonal 4 vjeçar që ka filluar në mars 2020 dhe financohet nga Instrumenti për Mbështetjen Para Anëtarësimit (IPA) të Bashkimit Evropian.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është forcimi i kapaciteteve të OSHC-ve (si të organizatave partnere të zbatimit të projektit ashtu edhe të organizatave me bazë në komunitet (grassroots) që do të përzgjidhen) për zhvillimin e politikave dhe avokimin në fushën e barazisë në arsim përmes bashkëpunimit rajonal dhe ngritjes së koalicioneve kombëtare. Çështja e varfërisë dhe e nxëniesve të prekur nga varfëria do të trajtohet në dy nivele: nga njëra anë, politikat arsimore dhe sociale që mund të ofrojnë zgjidhje afatgjata për krijimin e barazisë në arsim, dhe nga ana tjetër ndërhyrjet pilot në nivel shkolle që do të trajtojnë nevojat emergjente të nxëniesve me Status Social-Ekonomik (SSE) të ulët duke ofruar gjithashtu mësim dhe sugjerime ndihmëse për politikat.

Ju mund të gjeni më shumë detaje në lidhje me projektin në faqen tonë në Facebook: **Qendra për Arsim e Kosovës**, në ueb-faqen e **projektit ARISE** si edhe në faqen e **Facebook të projektit ARISE**



This project is funded by European Union

Thirrje për Pjesëmarrje

Qëllimi global i Thirrjes është ngritja e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile për të qenë aktorë efikasë dhe të përgjegjshëm, të aftë për t'u angazhuar në mënyrë konstruktive me aktorët përkatës në përfshirjen e fëmijëve nga grupet vulnerabël.

Objektivi specifik është të fuqizohen organizatat me bazë në komunitet për të trajtuar çështjet e fëmijëve me Status Social-Ekonomik (SSE) të ulët nëpërmjet aktiviteteve që synojnë forcimin e integritit të tyre më të mirë në jetën e komunitetit dhe rritjen e ndërgjegjësimit të aktorëve lokalë mbi ndikimin e SSE më të ulët në zhvillimin arsimor dhe personal të fëmijëve.

Rezultatet e pritshme të Thirrjes janë:

- Kapacitet i përmirësuar i organizatave me bazë në komunitet për trajtimin e çështjes së fëmijëve me SSE të ulët,
- Praktika të reja të integritit të fëmijëve me SSE të ulët në jetën e komunitetit

Në mënyrë që të jetë i ligjshëm për grantin, **aplikanti duhet:**

1. Të jetë një organizatë jo-qeveritare e krijuar dhe e regjistruar në Kosovë
2. Të ketë përvojë të verifikueshme prej të paktën një viti pune me komunitetet lokale dhe trajtimin e çështjeve të varfërisë dhe/ose të mbështetjes së fëmijëve me SSE të ulët,
3. Të operojë në qytetin/rajonin me përqindje të konsiderueshme të fëmijëve me SSE të ulët; organizatat nga qytete më të mëdha duhet të operojnë në një komunë që i plotëson këto kërkesa

Detaje të pjesëmarrjes dhe financimit:

- OSHC-ve të përzgjedhura do t'u jepet nga €25,000 deri në €35,000. Shuma maksimale e grantit prej €25,000 do të jepet nëse të ardhurat mesatare vjetore të organizatës gjatë 3 viteve të fundit nuk e kanë tejkaluar €15,000; Shuma maksimale e grantit prej €35,000 EUR mund të jepet nëse të ardhurat mesatare vjetore të organizatës gjatë 3 viteve të fundit i kanë tejkaluar €15,000.
- Nga shuma e dhënë, 10-15% e shumës totale do të caktohet për trajnime – ngritjen e kapaciteteve, mbështetjen në fushë , etj.,
- OSHC-ja e përzgjedhur dhe Qendra për Arsim e Kosovës – KEC, do të bashkëpunojnë ngushtë në të gjitha fazat e projektit ARISE,
- OSHC-ja e përzgjedhur dhe Qendra për Arsim e Kosovës – KEC bashkërisht do të hartojnë dhe implementojnë një Projekt që mbështet integrimin e fëmijëve me SSE të ulët në komunitet. Propozimi dhe buxheti i detajuar i projektit do të hartohen përmes bashkëpunimit të ndërsjellë dhe duke u bazuar në mirëkuptimin e përbashkët.



This project is funded by European Union

- Kohëzgjatja e projektit të parashikuar do të jetë nga 24 në 30 muaj,
- OSHC-të e përzgjedhura pritet të marrin pjesë në aktivitete të projektit të tilla si: vizita studimore, takime dhe evente të koalicionit, avokim, trajnime, etj. në nivel kombëtar dhe rajonal gjatë kohëzgjatjes së projektit.

Dokumentacioni për aplikim

Aplikantët duhet të dërgojnë:

Dokumente përkatëse që vërtetojnë ligjshmërinë/pështatshmërinë për pjesëmarrje në këtë Thirrje siç është specifikuar në paragrafin e mësipërm:

1. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së,
2. Forma e aplikimit,
3. Dokumente statistikore zyrtare apo raporte që dëshmojnë përqindjen e fëmijëve me SSE të ulët (p.sh. të dhëna publike nga Zyra të statistikave, hulumtime/kërkime shkencore të pavarura, raporte të OSHC-ve etj.) ,
4. Raportet financiare vjetore (bilancet) të organizatës për 3 vitet e fundit

I gjithë dokumentacioni duhet të dërgohet tek: ptahiri@kec-ks.org deri më 10 shtator 2020.

Para nënshkrimit të marrëveshjes së grantit do të bëhet verifikim për të siguruar që organizatat e para-zgjedhura me bazë në komunitet kanë kapacitetin të respektojnë procedurat dhe kërkesat e kontratës

Për më shumë informacion mbi Thirrjen, na kontaktoni në: ptahiri@kec-ks.org